



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – PREDSIEDNIK

DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr.03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik;

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes mbi Ekstradimin, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, e nënshkruar me 08 prill 2011, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 06 maj 2011.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-008-2011

Prishtinë, më 09 qershor 2011



Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

MARRËVESHJE
NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
MBI EKSTRADIMIN

PREAMBULA

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë tani e tutje të referuara si "Palët";

Në aspiratën e tyre për zhvillimin dhe forcimin e mëtutjeshëm të marrëdhënieve bilaterale në frymën e miqësisë ekzistuese dhe bashkëpunimin përkitazi me ekstradimin ndërmjet dy shteteve;

Duke marrë parasysh dëshirën për të marrë pjesë aktivisht në procesin e bashkëpunimit për Integrim Evropian;

Kanë rënë dakord me sa vijon:

KAPITULLI 1 **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Obligimi për Ekstradim**

1. Palët lejojnë dorëzimin tek njëra-tjetra, sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara me këtë Marrëveshje, e të gjithë personave kundër të cilëve autoritetet kompetente të Palës kërkuese kanë filluar procedimin gjyqësor për veprë penale ose personat që janë të kërkuar nga autoritetet e lartpërmendura për ekzekutimin e një dënimi apo urdhër-arresti.

2. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, shprehja "urdhër-arrest" do të thotë çdo urdhër që parasheh privimin nga liria, i cili është shqiptuar nga një gjykatë kompetente, si dënim plotësues ose si zëvendësim i dënimit me burg.

Neni 2 **Veprat penale të Ekstradueshme**

1. Ekstradimi lejohet për veprat penale të dënueshme sipas ligjeve të Palës kërkuese dhe të Palës së kërkuar me heqje lirie, apo lidhur me një urdhër-arrest i cili parasheh dënim me burgim për më së paku për një periudhë (1) një vjeçare, apo dënim më të rënd. Në raste të shqiptimit të një dënimi ose urdhër arresti të shpallur në territorin e shtetit kërkues, dënimi i shqiptuar duhet të jetë së paku për një periudhë kohore të paktën katër muaj.

2. Nëse kërkesa për ekstradim i referohet disa veprave penale të ndryshme ndaj të cilave në bazë të ligjit të aplikueshëm të dy Palëve, dënimi mbi privimin e lirisë apo urdhëri për arrest mbi deprivimin nga liria është përcaktuar, por disa prej tyre nuk i plotësojnë kushtet për kohëzgjatjen e dënimit, Pala e kërkuar mund të lejojë ekstradimin për këto vepra gjithashtu.

3. Kjo e drejtë zbatohet edhe për veprat penale që i nënshtrohen vetëm dënimeve me gjobë.

Neni 3 **Veprat Penale Politike**

1. Ekstradimi nuk do të lejohet në rastet kur vepra penale për të cilën është parashtruar kërkesa, nga Pala e kërkuar konsiderohet si veprë penale politike apo si veprë e lidhur me një veprë penale politike.

2. I njëjti rregull aplikohet nëse Pala e kërkuar, ka bazë të arsyeshme për të besuar se kërkesa për ekstradim për një veprë penale të zakonshme është bërë me qëllim të ndjekjes ose dënimit të një personi për shkak të racës, religjionit, kombësisë apo bindjeve politike të tij/saj, ose pozita e personit mund të paragjykohet për ndonjë nga këto arsye.

3. Privimi nga jeta apo tentativa për privim nga jeta të kryetarit të shtetit ose një anëtar të

familjes së tij/saj nuk do të konsiderohet të jetë një vepër politike për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

4. Ky Nen nuk do të cenoj obligimet që Palët Kontraktuese mund të kenë marrë ose mund të marrin sipas ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare.

Neni 4 Veprat Penale Ushtarake

Kjo marrëveshje përjashton ekstradimin për veprat të cilat konsiderohen vepra penale në bazë të ligjit ushtarak, po që me ligj penal të zakonshëm nuk parashihen si të tilla.

Neni 5 Veprat Penale Fiskale

1. Ekstradimi për veprat penale që kanë të bëjnë me taksat, tatimet, doganat dhe këmbimin, mund të lejohet, ndërmjet Palëve në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, nëse vepra penale për të cilën ekstradimi është kërkuar, përkon me një vepër penale të natyrës së njëjtë sipas ligjit të Palës kërkuuese.

2. Ekstradimi nuk mund të refuzohet me arsyen se ligji i Palës kërkuuese, nuk parasheh të njëjtin lloj tatimi ose takse ose nuk përmban rregullore për tatim, taksë, dogana ose këmbim të të njëjtit lloj, si ligji i Palës kërkuuese.

Neni 6 Ekstradimi i shtetasve

1. Çdo Palë ka të drejtë të refuzojë ekstradimin e shtetasve të saj.

1) „Shtetas“ i Republikës së Kosovës, konsiderohet çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Kosovës, në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës. „Shtetas“ i Republikës së Maqedonisë, konsiderohet çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Maqedonisë, në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm në Republikën e Maqedonisë.

2) Ekstradimi do të lejohet në rastet kur personi, ekstradimi i të cilit është kërkuar, është shtetas i Palës kërkuuese ndërsa pas fillimit të procedurës për ekstradim ka kërkuar shtetësinë e Palës së kërkuar.

2. Nëse Pala e kërkuar nuk ekstradon shtetasit e saj, me kërkesë të Palës kërkuuese, duhet të paraqet rastin tek autoritetet kompetente të saj në mënyrë që, nëse konsiderohet e arsyeshme, të iniciohet procedura gjyqësore. Për këtë qëllim, shkresat, informatat dhe provat materiale në lidhje me veprën penale, duhet të ofrohen pa pagesë në përputhje me Nenin 14 par.1. Pala kërkuuese duhet të informohet lidhur me rezultatet e kërkesës.

Neni 7
Vendi i kryerjes së Veprës Penale

1. Pala e kërkuar mund të refuzoj ekstradimin e një personi që kërkohet për një vepër penale e cila, në bazë të ligjit të saj, konsiderohet se është kryer pjesërisht apo plotësisht brenda territorit të saj.

2. Në rast se, vepra penale për të cilën është kërkuar ekstradimi, është kryer jashtë territorit të Palës kërkuese, ekstradimi mund të refuzohet vetëm nëse ligji i Palës së kërkuar nuk e lejon ndjekjen e veprave penale të asaj kategorie të cilat janë kryer jashtë territorit të saj, apo nuk e lejon ekstradimin për vepra të tilla.

Neni 8
Procedimet në Pritje për Vepra të Njëjta Penale

Pala e kërkuar mund të refuzoj ekstradimin e personit të kërkuar, nëse autoritetet kompetente të saj janë duke zhvilluar procedurë penale kundër atij/asaj personi në lidhje me veprën penale apo veprat penale për të cilat është kërkuar ekstradimi.

Neni 9
Non bis in idem

1. Ekstradimi nuk do të lejohet në rast se, autoritetet kompetente të Palës së kërkuar, kanë shpallur aktgjykim të formës së prerë kundër kryerstit të veprës apo veprave penale për të cilat është kërkuar ekstradimi. Ekstradimi mund të refuzohet në rast se, autoritetet kompetente të Palës së kërkuar, kanë vendosur të mos iniciojnë apo të përfundojnë procedurat lidhur me veprën apo veprat e njëjta penale.

2. Ekstradimi i personave, kundër të cilëve në një shtet të tretë është shpallur aktgjykimi i formës së prerë për veprën apo veprat penale për të cilat është kërkuar ekstradimi, duhet të refuzohet:

1) kur aktgjykimi është lirues,
2) kur dënimi me privim nga liria apo ndonjë urdhër tjetër i shpallur,
- qëndron në tërësi,
- ka qenë subjekt i amnestisë ose faljes në përgjithësi në pjesën e paekzekutushme

3) Kur gjykatësi ka gjetur se kryesi i veprës penale ka qenë fajtor, megjithatë nuk ka shpallur ndonjë dënim.

3. Sidoqoftë në rastet e cekura në Par. 2, ekstradimi mund të lejohet:

1) Nëse vepra penale lidhur me të cilën është shpallur vendimi, është kryer kundër personave, institucioneve publike të palës kërkuese;
2) Nëse personi kundër të cilit është shpallur vendimi ka pozitë publike në shtetin kërkues;

3) Vepra penale në bazë të së cilës është shpallur vendimi është kryer në tërësi territorin e shtetit kërkues.

4. Dispozitat e referuara në Par. 2 dhe 3, nuk duhet të paragjykojnë aplikimin e rregullave më të gjera shtetërore lidhur me efektet e *non bis in idem*, në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat jashtë shtetit.

Neni 10 Parashkrimi

Ekstradimi nuk lejohet në rastet kur në përputhje me legjislacionin e Palës së kërkuar ose Palës kërkuese, çështja penale ose dënimi janë parashkruar.

Neni 11 Dënimi me Vdekje

Nëse në bazë të ligjit të Palës kërkuese, për veprën penale për të cilën është kërkuar ekstradimi parashihet dënim me vdekje, dhe nëse në bazë të ligjit të Palës së kërkuar, për vepër penale të tillë nuk parashihet dënimi me vdekje, apo nuk ekzekutohet zakonisht, ekstradimi duhet të refuzohet përveç nëse Pala kërkuese i ofron Palës së kërkuar siguri të mjaftueshme se dënimi me vdekje nuk do të ekzekutohet.

Neni 12 Gjykimi në mungesë

1. Nëse njëra nga Palët kërkon ekstradimin e një personi me qëllim që të ekzekutoj një dënim apo urdhër arrest të caktuar nga një vendim të shpallur kundër tij/saj në mungesë, Pala kërkuese mund të refuzoj ekstradimin, nëse beson se procedura për marrjen e aktgjykimit nuk i përmbush të drejtat minimale të mbrojtjes që çdo person i akuzuar për një vepër penale i gëzon. Sidoqoftë, ekstradimi duhet të lejohet nëse Pala kërkuese ofron zotim, që konsiderohet i mjaftueshëm që t'i garantoj personit të kërkuar të drejtën për një rigjykim i cili i garanton të drejtat e mbrojtjes. Ky vendim e autorizon Palën kërkuese të ekzekutoj aktgjykimin në fjalë, nëse personi i dënuar nuk ka paraqitur kundërshtim apo, në qoftëse ai/ajo ka kundërshtuar, të filloj procedim gjyqësor kundër personit të ekstraduar.

2. Kur Pala e kërkuar informon personin për të cilin/cilën është kërkuar ekstradimi se kundër tij/saj është marr vendim në mungesë, Pala kërkuese nuk duhet të konsideroj këtë marrëveshje si njoftim zyrtar, për qëllime të procedurave penale në atë shtet.

Neni 13 Amnistia dhe Falja

Ekstradimi nuk duhet të lejohet për një vepër penale, e cila në Palën e kërkuar është amnistuar apo falur dhe për të cilën vepër penale, dhe e cila Palë ka pasur kompetencë për ta ndjekur penalisht sipas ligjit të saj penal.

KAPITULLI II

Procedura e Dorëzimit

Neni 14

Kërkesa dhe dokumentet mbështetëse

1. Kërkesa duhet të paraqitet në formë të shkruar nga Ministria e Drejtësisë e Palës kërkuese dhe duhet t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë së Palës së kërkuar. Sidoqoftë, shfrytëzimi i kanaleve diplomatike nuk duhet të përjashtohet.

2. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

1) origjinali apo kopja e vërtetuar e aktgjykimit mbi dënimin e shqiptuar, urdhër arrestit, apo ç'fardo akti tjetër ligjor me të njëjtin efekt ligjor, i marrë në mënyrën e përcaktuar me ligjin e Palës kërkuese.

2) përshkrimin e veprave penale për të cilat është kërkuar ekstradimi. Koha dhe vendi i kryerjes së veprave penale, përshkrimi ligjor i veprës penale; dhe

3) një kopje të dispozitave ligjore që aplikohen në lidhje me veprën penale ose, në qoftëse kjo nuk është e mundur, një deklaratë mbi ligjin që aplikohet dhe nëse është e mundur një përshkrim sa më të sakt të personit të kërkuar, së bashku me të dhëna të tjera që mundësojnë vërtetimin e identitetit dhe shtetësisë të tij/saj.

3. Pala kërkuese, duhet t'i paraqes Palës së kërkuar kërkesën së bashku me dokumentet shtesë:

1) në gjuhën Shqipe apo Serbe, si dhe një përkthim në gjuhën Maqedone, nëse Pala kërkuese është Republika e Kosovës.

2) në gjuhën Maqedone, si dhe një përkthim në gjuhën Shqipe apo Serbe, nëse Pala kërkuese është Republika e Maqedonisë.

Neni 15

Informatat plotësuese

Nëse informatat e ofruara nga Pala kërkuese, nga Pala e kërkuar konsiderohen të pamjaftueshme për të mundësuar vendosjen në përputhje me këtë Marrëveshje, kjo e fundit mund të kërkoj informata plotësuese dhe mund të caktoj një limit kohor për pranimin e tyre.

Neni 16

Arrestimi i përkohshëm

1. Në raste emergjente, Pala kërkuese mund të kërkojë arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar. Në lidhje me këtë Pala e kërkuar duhet të vendos në përputhje me ligjin e saj.

2. Kërkesa për arrestimin e përkohshëm duhet të potencoj se ekziston një nga dokumentet e përcaktuara në nenin 14, paragrafi 2(1), dhe se është planifikuar dërgimi i kërkesës për ekstradim. Gjithashtu, duhet të përmbaj konstatimin se për se për çfarë vepre penale do të

kërkohet ekstradimi, kur dhe ku është kryer vepra penale, si dhe të ofroj një përshkrim sa më të detajuar të personit të kërkuar.

3. Kërkesa për arrestim të përkohshëm duhet të paraqitet në formë të shkruar, me faks apo me ndonjë mjet tjetër, duke ofruar provat në formë të shkruar, ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë të të dy vendeve përkatëse. Pala e kërkuar duhet të njoftohet pa vonesë lidhur me rezultatin e kërkesës së saj.

4. Arresti i përkohshëm mund të ndërpritet në qoftë se, brenda një periudhe prej 18 ditëve pas arrestimit, Pala e kërkuar nuk ka pranuar kërkesën për ekstradim dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 14. Në çdo rast, kjo nuk duhet të tejkalojë periudhën prej 40 ditëve nga data e arrestimit. Mundësia e lirimimit me kusht, në çdo kohë, nuk është e përjashtuar, megjithatë, Pala e kërkuar duhet të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ikjen e personit të kërkuar.

5. Lirimi nuk duhet të paragjykoj ri-arrestin dhe ekstradimin në qoftë se kërkesa për ekstradim është paraqitur më vonë.

Neni 17

Kërkesat kontradiktore

Në rastet kur ekstradimi është kërkuar për të njëjtën vepër penale apo për vepra të ndryshme penale nga më shumë se një shtet, Pala e kërkuar duhet të vendos duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat dhe në veqanti, rrezikshmërinë dhe vendin e kryerjes së veprës penale, datat përkatëse të kërkesave, shtetësinë e personit të kërkuar dhe mundësinë e ekstradimit të mëvonshëm në një shtet tjetër.

Neni 18

Dorëzimi i personit për ekstradim

1. Pala e kërkuar duhet të njoftoj Palën kërkuuese lidhur me vendimin që ka marrë mbi ekstradimin, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Nenin 14 par. 1.

2. Refuzimi i plotë apo i pjesëshëm duhet të arsyetohet.

3. Nëse është rënë dakord lidhur me kërkesën, Pala kërkuuese duhet të informohet për vendin dhe datën e dorëzimit si dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së personit të kërkuar, i cili/e cila ishte arrestuar për qëllim të dorëzimit.

4. Në bazë të dispozitave të par. 5 të këtij neni, nëse në datën e caktuar nuk është bërë pranimi i personit të kërkuar, ai/ajo mund të lirohet pas skadimit të afatit prej 15 ditëve dhe për çdo rast duhet të lirohet pas skadimit të afatit prej 30 ditëve. Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin e tij/saj për të njëjtën vepër penale.

5. Nëse rrethanat jashtë kontrollit të Palës kërkuese, ia pamundësojnë asaj pranimin e personit të kërkuar për ekstradim, ajo duhet të njoftoj Palën tjetër. Të dy Palët duhet të caktojnë një datë të re, dhe në këtë rast dispozitat e par. 4 të këtij Neni duhet të aplikohen.

Neni 19

Shtyrja e dorëzimit apo dorëzimi i kushtëzuar

1. Pas marrjes së vendimit për ekstradim, Pala e kërkuar mund të vendos që të shtyjë dorëzimin e personit të kërkuar me qëllim që të zhvillojë procedurë penale kundër tij/saj në atë shtet apo, në rast se ky person tashmë është dënuar, Pala e kërkuar mund të shtyjë dorëzimin e tij/saj me qëllim që të ekzekutoj dënimin në territorin e saj për një veprë penale tjetër nga ajo për të cilën është kërkuar ekstradimi.

2. Pala e kërkuar mund të vendos që në vend të shtyrjes së dorëzimit, të bëjë dorëzimin e përkohshëm te Palës kërkuese të personit të kërkuar, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen me marrëveshje reciproke ndërmjet Palëve.

Neni 20

Dorëzimi i pasurisë

1. Pala e kërkuar duhet që, me kërkesë të Palës kërkuese dhe për aq sa e lejon ligji i saj, të bëjë konfiskimin dhe dorëzimin e pasurisë:

- 1) që mund të kërkohen si provë apo
- 2) që është fituar si rezultat i veprës penale, dhe e cila në kohën e arrestimit është gjetur në posedim të personit të kërkuar apo është zbuluar më vonë.

2. Pasuria e lartpërmendur në par. 1 të këtij Neni, duhet që të dorëzohet edhe në rast se ekstradimi i aprovuar nuk mund të ekzekutohet për shkak të vdekjes apo ikjes së personit të kërkuar.

3. Në rastet kur sendet e cekura më sipër janë të konfiskuara apo të sekuestruara në territorin e Palës së kërkuar në lidhje me procedurat penale të pezulluara, kjo e fundit, mund të vendos që përkohësisht të mos dorëzoj këtë pasuri apo që të kushtëzoj dorëzimin me kthimin e tyre.

4. Çdo e drejtë që Pala kërkuese apo ndonjë Palë e tretë mund të kenë mbi pasurinë e lartpërmendur, nuk duhet të cenohet. Në rast të ekzistimit të këtyre të drejtave, pas gjykimit, pasuria duhet të kthehet te Pala e kërkuar pa pagesë, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 21

Procedura

Përveç rasteve kur kjo Marrëveshje parasheh ndryshe, procedurat lidhur me ekstradimin apo arrestin e përkohshëm duhet të rregullohen vetëm me ligjin e Palës së kërkuar.

KAPITULLI III

Efektet e Dorëzimit

Neni 22

Parimi i Specialitetit

1. Personi i cili është ekstraduar nuk duhet të hetohet, dënohet apo arrestohet me qëllim të ekzekutimit të një dënimi apo urdhër-arresti për çfarëdo vepre tjetër penale, të kryer para dorëzimit të tij/saj përveç asaj për të cilën ai/ajo është ekstraduar, gjithashtu atij/asaj nuk do të i kufizohet liria personale, përveç në këto raste:

1) Në rastin kur Pala që e ka dorëzuar atë pajtohet. Kërkesa për pajtim duhet të paraqitet e mbështetur nga dokumentet e përcaktuara në Nenin 14 dhe nga regjistri ligjor i çdo deklarate të bërë nga personi i ekstraduar lidhur me veprën penale në fjalë. Pajtimi duhet të ipet në rastet kur vepra penale për të cilën është kërkuar është subjekt i ekstradimit në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.

2) Në rastin kur personi, edhe pse ka pasur mundësinë të largohet nga territori ku ai/ajo është dorëzuar, nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve prej momentit kur është shkarkuar nga vepra penale apo, pasi është larguar, është kthyer përsëri në atë territor.

2. Sidoqoftë, Pala kërkuese mund të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për largimin e këtij personi nga territori i saj apo, të marrë të gjitha masat e nevojshme në bazë të ligjit të saj, duke përfshirë edhe procedurat për mos paraqitje në afat kohor, që të parandaloj efektet juridike të parashkrimit.

3. Në rast se, përshkrimi i veprës penale me të cilën personi ka qenë i ngarkuar, gjatë zhvillimit të procedurës ka pësuar ndryshime, personi i ekstraduar mund të gjykohet apo të dënohet vetëm nëse vepra penale në bazë të përshkrimit të ri, shihet se ka elemente të veprës penale për të cilën ekstradimi është i lejuar.

Neni 23

Ekstradimi në shtetet e treta

Përveç rasteve të parapara në Nenin 22, par. 1(2), Pala kërkuese nuk mund që, pa pëlqimin e Palës së kërkuar, personin e pranuar t'i dorëzoj një shteti të tretë nëse kërkohet për vepra penale të kryera para dorëzimit të tij/saj. Pala e kërkuar mund të kërkoj sigurimin e dokumenteve të cekura në Nenin 14, par. 2 të kësaj Marrëveshje.

Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se gjatë zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshje, paraqiten mosmarrëveshje, ato duhet të zgjidhen në mënyra diplomatike.

KAPITULLI 4
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 25
Shpenzimet

Shpenzimet e kryera për shkak të ekstradimit në territorin e Palës së kërkuar, do t'i bartë ajo Palë.

Neni 26
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Marrëveshje duhet të aplikohen për të gjitha kërkesat për ekstradim përkitazi me aktet apo veprat penale të cilat janë të kryera pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 27
Hyrja në Fuqi dhe Përfundimi

1. Kjo Marrëveshje duhet t'i nënshtrohet procedurës së ratifikimit.
2. Kjo Marrëveshje hynë në fuqi 30 ditë pas pranimit të njoftimeve të fundit me të cilat Palët nënshkruese njoftojnë njëra tjetrën lidhur me procedurën e ratifikimit të zhvilluar në pajtueshmëri me ligjin e brendshëm.
3. Kjo Marrëveshje duhet të jetë në fuqi për një kohë të pacaktuar. Secila nga Palët ka të drejtën që në formë të shkruar, nëpërmes kanaleve diplomatike të bëjë denoncimin e kësaj marrëveshje. Në rast të tillë, kjo Marrëveshje duhet të shfuqizohet pas 6 mujave prej datës së paraqitjes së denoncimit.

E bërë në Prishtinë me 8 prill 2011 në dy kopje Shqip, Maqedonisht dhe Anglisht, të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të dallimeve në interpretim, Gjuha angleze do të ketë përparësi.

PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË


